KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA
DREJTORIA E ARSIMIT - UPRAVA ZA OBRAZOVANJE

| Pranuar - Primljeno: 06.07.2026 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. i organit / Br. Organa | Numri-Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 05- | 196/01 | – | - |

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova/Republic of Kosova

Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti

Drejtoria Komunale e Arsimit

---

Në bazë nenit 5, shkronjës b) të Ligjit nr 03/L-063 për Arsimin në Kommunat e Republikës së Kosovës Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjit nr. 04/L-138 për arsim dhe aftësim profesional, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës dhe dokument-qarkorës së MASHTI-it nr.3/2838, dt.29.06.2026 kushtet dhe kriteret për regjistrimin e nxënësve në klasat e dhjeta (10-të) në Gjimnaze dhe Insitutcionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional ( IAAP), DKA-ja e Komunës së Vitisë më datë 06.07.2026 shpall:

# KONKURS PUBLIK

## Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10-të) në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vitisë për vitin shkollor 2026-2027

**Kushtet dhe kriteret për regjistrimin e nxënsëve të rregullt:**

-Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe shkollave profesionale, për vitin shkollor 2026-2027, mund të konkurojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obliguar-fillor (1-9) dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

-Nxënësit të cilët kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Republikës së Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurojnë.

**Dokumentet e nevojshme për konkurim:**

-Fletëparaqitja, e cila merret në shkollën ku konkuron,
-Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët 6-9
-Certifikatën e lindjes.

**Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve:**

-Paraqitja e dokumenteve për Gjimnaz dhe shkolla Profesionale për vitin shkollor **2026-2027**, bëhet **më datë 07,08 dhe 09 korrik 2026** në lokalet e shkollës, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **8.00-16.00.**

-Shpallja e rezultateve për pranimin e nxënsëve bëhet më datë **10.07.2026,** në shkollën përkatëse (ku ka konkuruar) nxënësi.

-Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **13.07.2026.**

***-Shpallja e konkursit plotësues në muajin gusht , për vendet e lira më datë 17.08.2026***

***-Dorëzimi i dokumenteve për konkurs plotësues bëhet më datë 17, 18 dhe 19 gusht 2026***

***Shpallja e rezultateve për konkursin plotësues bëhet më 20.08.2026.***

Scanned with CamScanner

## Drejtimet dhe profilet

**Sh.M.L. Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës'' në Viti**

1.Gjimnazi-shkencat natyrore shtatë (7) paralele,
2.Gjimnazi-shkencat shoqërore (gjuhësore) gjashtë (6) paralele,

**SH.M.L.M. "Kongresi i Manastirit''në Pozhoran**

**Drejtimet e Gjimnazit:**

1.Shkencat natyrore një (2) paralele,
2.Shkencat shoqërore dy (2) paralele,

**Drejtimet profesionale në : SH.M.L.M. "Kongresi i Manastirit''në Pozhoran**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| "Kongresi i Manastirit" Pozhoran | Makineri, prodhim dhe ndërtimtari | Teknik i sistemeve solare fotovoltaike (Arsim dual) | 1 | 15 |
| | Ekonomi, administrim dhe juridik | Asistent juridik | 1 | 15 |
| | | Gjithsej: K. i Manastirit | 2 | 30 |

**IAAP "Jonuz Zejnullahu''në Viti**

| Komuna | Shkolla | Drejtimi | Profili | Nr.i paral. | Nr.i nxën. |
|---|---|---|---|---|---|
| Viti | "Jonuz Zejnullahu" | Teknologji e informacionit dhe komunikimit | Zhvillues i aplikacioneve softuerike | 1 | 17 |
| | | | Dizajn softueri | 1 | 17 |
| | | | Teknik i sistemeve të TIK-ut | 1 | 17 |
| | | | Teknik i elektronikës | 1 | 17 |
| | | Makineri, prodhim dhe ndërtimtari | Instalues elektrik | 1 | 17 |
| | | | Energjetikë | 1 | 17 |
| | | | Mekatronikë | 1 | 17 |
| | | | Operator i makinave me dirigjim kompjuterik-CNC | 1 | 17 |
| | | | Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit | 1 | 17 |
| | | | Automekanik (Arsim dual) | 1 | 17 |
| | | | Saldator | 1 | 17 |
| | | | Metalpunues | 1 | 17 |
| | | | Mekanik i sistemeve hidraulike dhe pneumatike | 1 | 17 |
| | | | Trafik rrugor | 1 | 17 |
| | | Agrokulturë, pylltari, peshkatari dhe veterinari | Përpunues i ushqimit dhe profesione të ngjashme | 1 | 17 |
| | | | Hortikulturë | 1 | 17 |
| | | Ekonomi, administrim dhe juridik | Banka dhe sigurime | 1 | 17 |
| | | | Asistent juridik | 1 | 17 |
| | | | Gjithsej: J. Zejnullahu | 18 | 306 |

Më 06.07.2026

**Drejtori**

Arta Ajeti